REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 2207/1 Prot Elbasan më 27/05/2021

VENDIM

Nr 41 datë 24/05/2021.

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin PRILL 2021

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 27.01.2021 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë"

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin PRILL 110 familje me fond 350.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

622
25.05.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 2208/1 Prot

Elbasan më 25 /05/ 2021

VENDIM
Nr. 42 datë 24 /05/2021

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike dhe pageses dyfishe nga fondi i kushtëzuar për muajin PRILL 2021

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 27.01.2021 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për blok-ndihmën ekonomike"

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike dhe pagese dyfishe nga fondet e kushtëzuara per muajin **PRILL 2021** gjithsej 209 familje me një fond prej 1.236.288 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

623

25-05-2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 22059/1 Prot. Elbasan, më 25.05.2021

VENDIM

Nr. 43 Datë : 24.05.2021

"Mbyllje proçedure privatizimi banesash shtetërore"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.05.2021 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve, Buxhetit dhe Financës, mbështetur në Ligjin 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", Dekretin e Presidentit të Republikës Nr.1440 datë 04.04.1996 "*Për trajtimin e banesave shtetërore të paprivatizuara*", Ligji Nr. 22/2018 "*Për Strehim Social*", VKM nr.179 datë 26.02.2020 "*Për rregullat, kushtet dhe proçedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992*", "*Për privatizimin e banesave shtetërore*", i ndyshuar dhe të ligjit nr.9321, datë 25.11.2004, " *Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore*";

VENDOSI:

1. Miraton **"Mbyllje proçedure privatizimi banesash shtetërore"** për qytetarët e mëposhtëm:

   - ***Z. Qerim Hasan Merkja*** disponon aktin e dhënies dhe të marrjes në dorëzim të banesës shtetërore për privatizimin e apartamentit të përbëre nga një dhomë dhe një kuzhinë (1+1), të ndodhur në lagjen "Beqir Dardha", pallati nr. 83, hyrja B, kati 5, apartamenti nr.17, Elbasan, <u>në emër të pjestarëve që përfitojnë sipas çertifikatës të gjëndjes familjare të datës 01.12.1992.</u>

   - ***Z. Xhemail Ali Zeneli*** disponon aktin e dhënies dhe të marrjes në dorëzim të banesës shtetërore për privatizimin e apartamentit të përbëre nga një dhomë dhe një kuzhinë (1+1), të ndodhur në lagjen "Vullnetari", pallati nr. 631, hyrja A, kati 5, apartamenti nr.1, Elbasan, <u>në emër të pjestarëve që përfitojnë sipas çertifikatës të gjëndjes familjare të datës 01.12.1992.</u>

   - ***Z. Tomorr Xhaferr Goga*** disponon aktin e dhënies dhe të marrjes në dorëzim të banesës shtetërore për privatizimin e apartamentit të përbëre nga dy dhoma dhe një kuzhinë (2+1), të ndodhur në lagjen "5 Maj", pallati 717, kati 1, apartamenti nr.1, Elbasan, <u>në emër të pjestarëve që përfitojnë sipas çertifikatës të gjëndjes familjare të datës 01.12.1992.</u>

2. Tarifat e pagesës së privatizimit do të bëhen në mbështetje të VKM nr.179 datë 26.02.2020.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të . Ardhurave Aseteve, Buxhetit dhe Financës

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd GRIPSHI

KRYETARI

Hektor ÇIFTJA

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA ELBASAN -

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.2210/1 Prot. Elbasan, më 25.05.2021

VENDIM

Nr. 44 Datë: 24.05.2021

"Mbi dhënie me qira (rinovim kontrate) të ambjentit "kuzhinë" në konviktin e shkollës së mesme profesionale "Luigj Gurakuqi""

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.05.2021 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, (sektori i pronave) bazuar në ligjin Nr.139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*, V.K.M Nr. 416 datë 11.07.2007 *"Për miratimin e listës përfundimtare të Pronave të Paluajteshme të Shtetit që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan"*, V.K.M Nr. 54 datë 05.02.2014 *"Për përcaktimin e kritereve, të proçedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore"*, i ndryshuar, V.K.B Nr. _____ datë 24.05.2021 *"Për një ndryshim në V.K.B Nr. 145 datë 27.11.2020 "Mbi miratimin e tarifave të ambjenteve që jepen me qira nga Bashkia Elbasan dhe shfuqizimin e V.K.B nr. 24 datë 24.02.2009""*;

VENDOSI:

1. Miraton dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit "kuzhinë" të konviktit të shkollës së mesme profesionale "Luigj Gurakuqi" me nr. pasurie 7/93 ndodhur në Lagjen "Luigj Gurakuqi", Z.K. 8521 me sipërfaqe 153 m^2, për t'u përdorur për "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për nxënësit e konviktit të shkollës së mesme profesionale" (Katering) të Bashkisë Elbasan, me tarifë qiraje mujore 300 (treqind) lekë/m^2, subjektit "Olta Sharra" me afat 1 (një) vit nga data 26.04.2021 deri më 25.04.2022.

2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, (sektori i pronave), Drejtoria Buxhetit dhe Drejtoria Financës.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

SEKRETAR
Klajd Gripshi

KRYETAR
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2211/1 **Prot.** **Elbasan, më** 25 **.05.2021**

V E N D I M

Nr. 45 **Datë:** 24 **.05.2021**

"Mbi miratimin e fillimit të proçedurave për kërkimin e kalimit në pronësi të Bashkisë Elbasan, të objektit "pallat" nr.733/2 ndodhur në lagjen "5 Maji ".

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës____.05.2021, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë *"Mbi miratimin e fillimit të proçedurave për kërkimin e kalimit në pronësi të Bashkisë Elbasan, të objektit "pallat" nr.733/2 ndodhur në lagjen "5 Maji "*, bazuar në ligjin nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* si dhe ligjin nr. 8744, datë 22.01.2001 *"Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësinë e qeverisjes vendore"*, i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 20/2020 *"Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"*

V E N D O S I:

1. Miraton fillimin e proçedurave për kërkimin e kalimit në pronësi të Bashkisë Elbasan, të objektit "pallat" nr.733/2 ndodhur në lagjen "5 Maji", me qëllim përfundimin e proçedurave të privatizimit.

2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

626
25.05.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.2212/1 Prot. **Elbasan, më 21.05.2021**

V E N D I M

Nr.46 Datë:24.05.2021

"Mbi dhënie në përdorim, pa kundërshpërblim (rinovim kontrate) të ambjentit ish-DRSHTRR Lagja"Hekurudha", U.K.E sh.a. nga Bashkia Elbasan"".

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.05.2021 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, bazuar në ligjin Nr.139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*, V.K.M Nr. 54 datë 05.02.2014 *"Për përcaktimin e kritereve, të proçedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore"*, i ndryshuar; ligjin Nr. 7850 datë 29.07.1994 *"Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar;

V E N D O S I :

1. Miraton dhënien në përdorim, pa kundërshpërblim (rinovim kontrate) të ambientit ish-DRSHTRR me sipërfaqe 209 m^2 ndërtesë dhe 740 m^2 truall, ndodhur në Lagjen "Hekurudha", Z.K 8523, për t'u përdorur si zyra të U.K.E Sh.A., për periudhën 1 (një) vjeçare nga data 01.04.2021 deri më 31.03.2022 (planvendosje bashkëlidhur).
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Përgjithëshme Operacionale.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2225/1 Prot. Elbasan më, 24.5.2021

VENDIM

Nr. 97 datë: 24.5.2021

"Për caktimin e numrit të strukturave komunitare për çdo lagje, datën e zgjedhjeve për këshillat komunitare dhe komisionet për strukturat komunitare, që do të ndjekin proçesin zgjedhor në qytet"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.5.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Koordinimit të Njësive Administrative dhe Lagjeve "*Për caktimin e numrit të strukturave komunitare për çdo lagje, datën e zgjedhjeve për këshillat komunitare dhe komisionet për strukturat komunitare, që do të ndjekin proçesin zgjedhor në qytet*", mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) dhe në VKB nr.172 datë 24.12.2020 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e strukturave komunitare në qytet, Bashkia Elbasan"";

VENDOSI:

1. **Numri i strukturave komunitare në qytet, për çdo lagje, do të jetë:**

Lagja Nr.1	5 struktura;
Lagja Nr.2	5 struktura;
Lagja Nr.3	7 struktura;
Lagja Nr.4	5 struktura;
Lagja Nr.5	3 struktura;
Lagja Nr.6	5 struktura;
Totali	*30 struktura*

2. **Datat e zgjedhjeve për këshillat komunitar në qytet do të jenë:**

Lagja Nr.1 datë 05 - 06.7.2021;

Lagja Nr.2 datë 05 - 06.7.2021;

Lagja Nr.3 datë 05 - 06.7.2021;

Lagja Nr.4 datë 05 - 06.7.2021;

Lagja Nr.5 datë 05 - 06.7.2021;

Lagja Nr.6 datë 05 - 06.7.2021;

3. **Komisionet për strukturat komunitare në qytet, për çdo lagje, që do të ndjekin proçesin zgjedhor të strukturave komunitare, do të përbëhen nga 7 veta, nga të cilët 3 anëtarë këshilli bashkiak, 3 anëtarë nga shoqëria civile dhe 1 anëtar administratori i lagjes:**

- ***Lagja Nr.1***

1) Arbër Gjeka anëtar i Këshillit Bashkiak;
2) Ermira Bajrami anëtar i Këshillit Bashkiak;
3) Luan Rama anëtar i Këshillit Bashkiak;
4) Ilir Gjoni shoqëri civile;
5) Fatma Spahiu shoqëri civile;
6) Diana Kasa shoqëri civile;
7) Dorina Rroseni administrator i lagjes;

- ***Lagja Nr.2***

1) Ermira Mrupi anëtar i Këshillit Bashkiak;
2) Imelda Sejdiu anëtar i Këshillit Bashkiak;
3) Ayon Somorxhiu anëtar i Këshillit Bashkiak;
4) Mirela Gjoni shoqëri civile;
5) Dhoksa Qyku shoqëri civile;
6) Alketa Hasani shoqëri civile;
7) Elsid Zyma administrator i lagjes;

- ***Lagja Nr.3***

1) Eva Bica — anëtar i Këshillit Bashkiak;
2) Kejsi Çapja — anëtar i Këshillit Bashkiak;
3) Emmir Çela — anëtar i Këshillit Bashkiak;
4) Elona Deliu — shoqëri civile;
5) Sokol Lulgjuraj — shoqëri civile;
6) Arben Rankaj — shoqëri civile;
7) Eugert Salla — administrator i lagjes;

- ***Lagja Nr.4***

1) Elsoi Gullhaj — anëtar i Këshillit Bashkiak;
2) Meta Fonga — anëtar i Këshillit Bashkiak;
3) Endrit Abdia — anëtar i Këshillit Bashkiak;
4) Enver Mustafaraj — shoqëri civile;
5) Elvis Çota — shoqëri civile;
6) Esmeralda Mallosi — shoqëri civile;
7) Arben Demiri — administrator i lagjes;

- ***Lagja Nr.5***

1) Mada Teta — anëtar i Këshillit Bashkiak;
2) Brisolda Gjoza — anëtar i Këshillit Bashkiak;
3) Sokol Sinani — anëtar i Këshillit Bashkiak;
4) Rudina Çollaku — shoqëri civile;
5) Bukuroshe Manaj — shoqëri civile;
6) Indrit Abdiaj — shoqëri civile;
7) Agron Lulaj — administrator i lagjes;

- ***Lagja Nr.6***

1) Sonofin Papa anëtar i Këshillit Bashkiak;

2) Roxhi Rakipi anëtar i Këshillit Bashkiak;

3) Nadire Pisha anëtar i Këshillit Bashkiak;

4) Besnik Bodurri shoqëri civile;

5) Fatmir Popja shoqëri civile;

6) Elvis Kotherja shoqëri civile;

7) Gëzim Keçi administrator i lagjes;

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Koordinimit të Njësive Administrative dhe Lagjeve, Administratorët e 6 lagjeve dhe Këshilli Bashkiak.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA ELBASAN

628
25.05.2021

7 (3)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2124 Prot. Elbasan më, 25 .5.2021

VENDIM

Nr. 48 datë: 24 .5.2021

"Për shpërblimin e kryetarëve të fshatrave dhe ndërlidhësave komunitar"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.5.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Koordinimit të Njësive Administrative dhe Lagjeve ***"Për shperblimin e kryetarëve të fshatrave dhe ndërlidhësave komunitar",*** mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), ligjin nr.10405, date 24.03.2011 "Per kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve" dhe në VKM nr.165 datë 02.3.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" (i ndryshuar);

VENDOSI:

1. Miratimin e shperblimit mujor te kryetareve te fshatrave ne masen:
   - 9% te pages bruto te administratorit te njesise administrative, per fshatrat me deri ne 500 banore;
   - 10% e pages bruto te administratorit te njesise administrative, per fshatrat me mbi 500 banore;
2. Miratimin e shperblimit mujor te nderlidhesave komunitar ne masen 9% te pages bruto te administratorit te lagjes.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2253/1 Prot. Elbasan, më 25.05.2021

VENDIM

Nr. 49 Datë: 24.05.2021

"Për një ndryshim në V.K.B nr. 145 datë 27.11.2020 "Mbi miratimin e tarifave të ambjenteve që jepen me qira nga Bashkia Elbasan dhe shfuqizimin e V.K.B nr.24 datë 24.02.2009"".

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.05.2021 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Operiacionale dhe Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, (sektori i pronave) bazuar në ligjin Bazuar në ligjin nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, V.K.M Nr. 672, datë 02.09.2020 *"Për disa ndryshime në Vendimin nr. 54 datë 05.02.2014 te Keshillit te Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të proçedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore""*, të ndryshuar Urdhërit Nr 865,date 27.10.2020, të Kryetarit të Bashkisë, "Për vlerësimin dhe përcaktimin e vlerës së qirasë ", dhe Realcionit me nr. 5171/2 prot., datë 07.05.2021 "Për vlerësimin dhe përcaktimin e vlerës së qirasë ";

VENDOSI:

1. Miraton ndryshimin në V.K.B nr. 145 datë 27.11.2020 *"Mbi miratimin e tarifave të ambjenteve që jepen me qira nga Bashkia Elbasan dhe shfuqizimin e V.K.B nr.24 datë 24.02.2009""* me tarifat e propozuara nga grupi i punës si më poshtë:

- Ndërtesë — 300 lekë/m^2
- Truall i lirë — 100 lekë/m^2 në zonën urbane; 40 lekë/m^2 në zonën rurale
- Tunelet dhe vendstrehimet — 200 lekë/m^2

2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimësinë e proçedurës së mëtejshme ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Operacionale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETAR
Hektor Çiftja

REPUBLIKA SHQIPERISE BASHKIA ELBASAN

630
26.5.2021

6

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2227/1 **Prot.** **Elbasan, më** 25**.5.2021**

VENDIM

Nr. 50 **datë** 24**.5.2021**

"Për miratimin e dhënies me qira të ambjenteve në godinën e pallatit të sportit "Tomorr Sinani", në lgj. "Dyli Haxhire", nga Bashkia Elbasan"

Këshilli Bashkiak Elbasan, në mbledhjen e tij të datës ___.5.2021, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Klubi Shumësportesh Bashkia Elbasan, bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), në VKM nr.416 datë 11.7.2007 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme të shtetit, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Elbasan" (i ndryshuar), në VKM nr.54 datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të proçedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore" (i ndryshuar).

V E N D O S I:

4) Të miratojë dhënien me qira të ambjenteve në godinën e pallatit të sportit "Tomorr Sinani", në lgj. "Dyli Haxhire", subjekteve private si mëposhtë vijon:

   f. Subjektit qiramarrës, ***zj. Vetiana GICA,*** (duke i bashkëlidhur dokumentacionin e kërkuar, sipas VKM nr.54 datë 05.02.2014), i jep me qira një ambjent, "dhomë", që ndodhet në katin përdhes, hyrja lindore e godinës, me sipërfaqe 56.7 m^2, me tarifë mujore qiraje 600 lekë / m^2, me afat 1 vjeçar, nga 01.01.2021 - 31.12.2021;

   g. Subjektit qiramarrës, ***zj. Vetiana GICA,*** (duke i bashkëlidhur dokumentacionin e kërkuar, sipas VKM nr.54 datë 05.02.2014), i jep me qira një ambjent, "dhomë", që ndodhet në katin përdhes, hyrja lindore e godinës, me sipërfaqe 32.4 m^2, me tarifë mujore qiraje 600 lekë / m^2, me afat 1 vjeçar, nga 01.01.2021 - 31.12.2021;

   h. Subjektit qiramarrës, ***z. Mario KOÇIAJ,*** (duke i bashkëlidhur dokumentacionin e kërkuar, sipas VKM nr.54 datë 05.02.2014), i jep me qira një ambjent, "dhomë", që ndodhet në katin përdhes, hyrja juglindore e godinës, me sipërfaqe 34.41 m^2, me tarifë mujore qiraje 600 lekë / m^2, me afat 1 vjeçar, nga 01.01.2021 - 31.12.2021;

   i. Subjektit qiramarrës, ***z. Jorgji BIQIKU,*** (duke i bashkëlidhur dokumentacionin e kërkuar, sipas VKM nr.54 datë 05.02.2014), i jep me qira një ambjent, "dhomë" (riparime elektrike dhe elektronike), që ndodhet në katin përdhes, hyrja perëndimore e godinës, me sipërfaqe

19 m^2, me tarifë mujore qiraje 300 lekë / m^2, me afat 1 vjeçar, nga 01.01.2021 - 31.12.2021;

j. Subjektit qiramarrës, ***"ERA TRAVEL 2013" sh.p.k.,*** (duke i bashkëlidhur dokumentacionin e kërkuar, sipas VKM nr.54 datë 05.02.2014), i jep me qira një ambjent, "dhomë" (Holl pasagjerësh), që ndodhet në katin përdhes, hyrja Veriore e godinës, me sipërfaqe 20 m^2, me tarifë mujore qiraje 300 lekë / m^2, me afat 1 vjeçar, nga 01.01.2021 - 31.12.2021.

5) Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Klubi Shumësportesh Bashkia Elbasan dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës.

6) Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

631
28.05.2021

13 (9)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2203/2 **Prot.** **Datë** 25 **.05. 2021**

VENDIM

NR. 51 **DATË** 24 **. 05. 2021**

"Detajim i shtesës së fondeve nga transferta e pakushtëzuar"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.05.2021, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi "Detajim i shtesës së fondeve nga transferta e pakushtëzuar", bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin nr.137, datë 16.11.2020 "Për buxhetin e vitit 2021", Udhëzimin Plotësues nr.4, date 25.01.2021 të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021",

VENDOSI

1. Detajimin e shtesës së fondeve nga transferta e pakushtezuar (grant), për vitin 2021, si më poshtë :

Njësia shpenzuese	Emërtimi i shpenzimit	Programi	Kapitulli	Artikulli	shuma/lekë
Bashkia	Bonus strehimi	10661	1	606	9,359,000
ASHP	Ndriçim rrugor	06440	1	602	5,641,000
Gjithsej :					**15,000,000**

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Financës dhe ASHP.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr "Qemal Stafa",Tel. +355 54 400152,E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

10 32

632
25.05.2021

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK I QYTETIT ELBASAN

Nr. 2230/1 **Prot.** **Datë** 25 **.05. 2021**

VENDIM

NR. 52 **DATE** 24 **. 05. 2021**

MBI

"SHTESË E TË ARDHURAVE TË TRASHËGUARA DHE E SHPENZIMEVE, NË BUXHETIN E VITIT 2021"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin nr. 137/2020, datë 16.11.2020 "Për buxhetin e vitit 2021", Vendimin e Këshilli Bashkiak Nr.168, datë 24.12.2020 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2021", pasi mori në shqyrtim materialet mbi "Shtesë e të ardhurave të trashëguara dhe e shpenzimeve, në buxhetin e vitit 2021", përgatitur nga administrata e Bashkisë Elbasan,

VENDOSI

1. Të miratojë rritjen e të ardhurave të trashëguara dhe të shpenzimeve, pjesë e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2021, si më poshtë dhe sipas pasqyrave bashkëlidhur :

   A. Të ardhura gjithsej: 89,994,420.67 lekë

   B. Shpenzime gjithsej : 89,994,420.67 lekë

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe njësitë shpenzuese.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Klajd Gripshi

KRYETAR
Hektor Çiftja

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr "Qemal Stafa",Tel. +355 54 400152,E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

633
25.5.2021

(11) (3)

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2203/3 Prot. Datë 25 .05. 2021

VENDIM

NR. 53 DATË 24 . 05. 2021

MBI

"Miratim në parim i Raportit të Performancës, viti 2020"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.05.2021, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi **""Miratim në parim i Raportit të Performancës, viti 2020",** bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 48, pika 1, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.22, date 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore",

VENDOSI

1. Të miratojë në parim "Raportin e Performancës, viti 2020", sipas materialit bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Klajd Gripshi

KRYETAR
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA ELBASAN

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr "Qemal Stafa",Tel. +355 54 400152,E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

634
25.05.2021

12

5

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2215/1 **Prot.** **Datë** 25 **.05. 2021**

VENDIM

NR. 54 **DATË** 24 **. 05. 2021**

MBI

"Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2021"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___ .05.2021, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi **"Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2021"**, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 48, pika 1, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.22, date 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore",

VENDOSI

1. Të miratoje "Raportin e monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2021", për Bashkinë Elbasan, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr "Qemal Stafa".Tel. +355 54 400152.E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

635
25.05.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2226/1 Prot. Elbasan, më 25.5.2021

VENDIM

Nr. 55 datë 24.5.2021

"Për miratimin e ekipeve sportive dhe të trajnerëve përkatës të Klubit Shumësportesh, Bashkia Elbasan, për sezonin sportiv vjetor 2021"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës ___.5.2021, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Klubi Shumësportesh i Bashkisë Elbasan *"Për miratimin e ekipeve sportive dhe të trajnerëve përkatës të Klubit Shumësportesh, Bashkia Elbasan, për sezonin sportiv vjetor 2021"*, mbështetur në:

a) Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar);
b) Ligjin nr.79/2017 "Për sportin" (i ndryshuar);
c) Ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";

VENDOSI:

1. Të miratojë ekipet sportive dhe trajnerët përkatës të Klubit Shumësportesh, Bashkia Elbasan, për sezonin sportiv vjetor 2021, si më poshtë:

Nr.	*Disiplinat Sportive / Ekipet*	*Trajneri*	*Nr. i sportistëve*
	VOLEJBOLL	4	28
1	Të Rritur	1	8
2	Të Rinj	1	6
3	Të Rritura	1	8
4	Të Reja	1	6

	BASKETBOLL	**4**	**22**
5	Të Rritur	1	7
6	Të Rinj	1	5
7	Të Rritura	1	10
8	Të Rritura / Të Reja	1	-
	HENDBOLL	**1**	**7**
9	Të Rritur	1	7
	PESHËNGRITJE	**4**	**14**
10	Të Rritur	1	5
11	Të Rinj	1	4
12	Të Rritura	1	3
13	Të Reja	1	2
	KARATE	**3**	**11**
14	Të Rritur	1	4
15	Të Rinj	1	4
16	Të Rritura / Të Reja	1	3
	ALPINIZËM	**1**	**5**
17	Të Rritur (M & F)	1	5
	CIKLIZËM	**1**	**5**
18	Të Rritur	1	5
	PING - PONG	**2**	**7**
19	Meshkuj	1	4
20	Femra	1	3
	ATLETIKË	**3**	**8**
21	Të Rritur	1	2
22	Të Rinj	1	2
23	Të Rritura / Të Reja	1	4

	QITJE	**2**	**4**
24	Meshkuj	1	3
25	Femra	1	1
	SNOOKER	**1**	**1**
26	Të Rritur	1	1
	TAEKWONDO	**1**	**2**
27	Meshkuj & Femra	1	2
	JUDO	**1**	**2**
28	Meshkuj	1	2
	RADIOAMATORIZËM	**1**	**1**
29	Meshkuj & Femra	1	1
	BOKS	**1**	**2**
30	Meshkuj	1	2

2. Ngarkohen Klubi Shumësportesh, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Financës në Bashkinë Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

636
25.05.2021

(14) (3)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 2213/1 Prot

Elbasan, më 25.05.2021

VENDIM

NR. 56 DATË 24.05.2021

PËR

MIRATIM DHËNIE BURSE NGA BUXHETI I BRENDSHËM I BASHKISË NXËNËSIT TË SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE "ALI MYFTIU" PËR VITIN SHKOLLOR 2020 - 2021

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____.____2021 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Arsimit dhe Edukimit " Mbi dhënien e bursës së shtetit nxënësve të shkollave të mesme të arsimit parauniversitar dhe profesional për vitin shkollor 2020-2021", bazuar në ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.666 datë 10.10.2019 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet e arsimit publik", për vitin shkollor 2020-2021", me propozim të komisionit të dhënies së bursave të ngritur me urdhër të brendshëm nr.981 datë 14.12.2020 nga kryetari i bashkisë.

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e bursës nga buxheti i brendshëm i bashkisë nxënësit të shkollës së mesme profesionale "Ali Myftiu", Musa Astrit Xhyra, për vitin shkollor 2020-2021 sipas tabelës bashkëngjitur vendimit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi për shkollat e mesme ngarkohet Drejtoria e Politikave të Arsimit dhe Edukimit dhe Qendra Ekonomike Arsimit, bashkia Elbasan.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

637
25.05.2021

16 (8)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 2229/1 prot

Elbasan më 25.05. 2021

VENDIM

Nr 57 /datë 24/ 05 /2021

"Për miratimin e zbatimit të projektit "Ngritja e shërbimeve komunitare multifunksionale për fëmijët, të rinjtë dhe familjen në Njësinë Administrative Shushicë", në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondacionit zvicerian "Terre des Hommes", për periudhën 2021 - 2023"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.5.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar "*Për miratimin e zbatimit të projektit "Ngritja e shërbimeve komunitare multifunksionale për fëmijët, të rinjtë dhe familjen në Njësinë Administrative Shushicë", në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondacionit zvicerian "Terre des Hommes", për periudhën 2021 - 2023"*, mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), në ligjin nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në R.Sh.", në VKM nr.518 datë 04.9.2018 "Për përcaktimin e kritereve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror",

VENDOSI

1 Të miratojë zbatimin e projektit "Ngritja e shërbimeve komunitare multifunksionale për fëmijët, të rinjtë dhe familjen në Njësinë Administrative Shushicë", në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondacionin zvicerian "Terre des Hommes", për periudhën 2021 - 2023, sipas fazave.

2 Të miratojë shpenzimet buxhetore për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime të tjera, sipas tabelës bashkëlidhur.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

1 → 7 10

638
25.05.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2264/1 **Prot.** **Elbasan, më** 25.05.**2021**

VENDIM

Nr. 58 **datë** 24.05.**2021**

"Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik për ndërtimin e HEC-eve "Gostima" në Lumin e Gostimës , nga subjekti "EGNATIA HYDROPOWER" sh.p.k."

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës ___.___.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësor, Veterinar dhe Mjedisit, i mbështetur në:

a) Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar);
b) Ligjin nr.57/2020 "Për pyjet";
c) Ligjin nr.9693 datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor" (i ndryshuar);
d) VKM nr.1353 datë 10.10.2008 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe proçedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor" (i ndryshuar);
e) VKM nr.433 datë 08.6.2016 "Për transferimin, në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave / bashkive" (i ndryshuar);
f) Udhëzimin e MM nr.1 datë 09.6.2016 "Për rregullat, proçedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik";

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim dhënien në përdorim, me kontratë qiraje, të fondit pyjor e kullosor publik, sipas listës bashkëlidhur dhe planvendosjes së sipërfaqes mbi të cilën do të shtrihet tubacioni i transmetimit të ujit për ndërtimin e HEC-eve "Gostima" në Lumin Gostimë, për të cilin proçedura e dhënies së lejes ka nisur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

2. Të miratojë në parim heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor të **0.10** ha sipërfaqe pyjore në ngastrat nr. 35/c,42,66 për Hec_in "Gostimë 2" në ekonominë pyjore Shpat 1; ngastra nr. 83/b për Hec_in "Gostimë 4" në ekonominë pyjore Shpat 1; ngastra nr. 1/a në ekonominë pyjore Shpat 2, ngastrën 4/a në ekonominë pyjore Polis-Vasjan për Hec_in "Gostimë 5".

3. Afati i dhënies në përdorim, sipas pikës 1 të këtij vendimi, do të jetë 9 vjet, ndërsa tarifat e përcaktuara në VKM nr.391 datë 21.6.2006 (i ndryshuar), përbëjnë vlerën e qirasë vjetore.

4. Kjo kontratë do t'i fillojë efektet e saj pas miratimit përfundimtar të ndërtimit të objektit (burim gjenerues energjie) nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
5. Kjo kontrate nuk do te preke prurjen prej $2m^3$/sec që nevojitet për projektin e ujësjellësit.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjthshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës (Drejtoria e Aseteve, Pronave dhe Strehimit) si dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësor, Veterinar dhe Mjedisit.

7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

638
25.05.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2263/1 Prot. Elbasan, më 25.05.2021

VENDIM

Nr. 59 datë 24.05.2021

"Për miratimin e proçedurës për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale që kalojnë në pronësi të Bashkisë Elbasan, nga ndërtimet e reja"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.___.2021, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve *"Për miratimin e proçedurës për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale që kalojnë në pronësi të Bashkisë Elbasan, nga ndërtimet e reja"*, mbështetur në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar);
- Ligjin nr.22/2018 "Për strehimin social";
- Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë;
- VKM nr.626 datë 15.7.2015 "Për miratimin e normativave të projektimit të banesave";
- Shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.1931/1 prot. datë 12.3.2019, drejtuar Bashkisë Elbasan;

VENDOSI:

1. *Të miratojë proçedurën për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale që kalojnë në pronësi të Bashkisë Elbasan, nga ndërtimet e reja:*
   1.1 Çdo zhvillues privat që ka aplikuar pas datës 30.11.2018 për leje ndërtimi me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2.000m^2, për nevoja të fondit publik të banesave sociale, detyrohet të kaloj pa shpërblim, në favor të Bashkisë Elbasan, 3% të sipërfaqes funksionale ndërtimore në pronësi të investitorit / zhvilluesit;
   1.2 Sipërfaqja që detyrohet të dorëzojë subjekti privat për strehimin social sigurohet në

objektin për të cilin aplikohet për leje ndërtimi;

1.3 Subjekti privat mund të propozoj që sipërfaqja e përcaktuar në pikën 1.1, të këtij vendimi, ta ofroj në një objekt tjetër në pronësi të tij;

1.4 Sipërfaqja takuese që i jepet bashkisë, sipas parashikimeve të këtij vendimi, parashikohet dhe është pjesë e projektit që aplikohet për leje ndërtimi, nga zhvilluesi privat;

1.5 Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve, perllogarit siperfaqet ndertimore per banim qe perbejne 3% te siperfaqes funksionale dhe njofton zhvilluesin në vendimin e miratimit të lejes së ndërtimit. Përllogaritja i relatohet Drejtorisë së Aseteve, Pronave dhe Strehimit dhe Drejtorisë Juridike për hartimin e akt - marrëveshjes së kalimit të ketyre sipërfaqeve në favor të Bashkisë Elbasan. Akt – marrëveshja e nënshkruar, midis bashkisë dhe zhvilluesve privat, ngarkohet në dokumentacionin për miratimin e njoftim fillim punimeve bëhet me akt noterial.

1.6 Në çdo rast, kalimi fizik i pasurive të përfituara sipas këtij vendimi, bëhet jo më vonë se në momentin e lëshimit të çertifikatës së përdorimit nga struktura përgjegjëse e planifikimit të territorit, sipas parashikimit të legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;

1.7 Në rast se sipërfaqja takuese në favor të Bashkisë Elbasan, sipas parashikimeve të këtij vendimi, nuk mund të përbëjë, për shkak të sipërfaqes, një ambjent banimi referuar VKM-në nr. 626, datë 15.7.2015, "Për miratimin e normativave të projektimit të banesave", zhvilluesi privat e ofron atë në një objekt tjetër të tij, brënda të së njëjtës njësi administrative ku ai po zhvillon apo edhe do të konvertohet në formulën financiare përfituese në lek/m2 referuar çmimit të tregut miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave sipas vitit referues, për Njësinë Vendore, nëse mundësitë sipas standarteve të projektimit në zbatim të kuadrit teknik ligjor për apartamente banimi nuk zbatohen. Vlera e përfituar shkon në buxhetin e Bashkisë Elbasan, në programin e strehimit social;

1.8 Kur, nga Bashkia Elbasan, aplikohet që sipërfaqja takuese të konvertohet sipas parashikimeve të pikës 1.6 të këtij vendimi, akt - marrëveshja e nënshkruar midis bashkisë dhe zhvilluesit privat duhet të përmbajë edhe vlerën e saktë që duhet të paguaj ky i fundit në favor të bashkisë;

1.9 Akt - marrëveshja, që nënshkruhet mes Bashkisë Elbasan dhe zhvilluesit privat, për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës në favor të Bashkisë Elbasan;

1.10 Për të gjitha lejet e ndërtimit të lëshuara pas datës 30.11.2018, Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve njofton dhe u kërkon subjekteve që janë objekt i nenit 19 të ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social", të paraqiten pranë Bashkisë për përllogaritjen dhe përcaktimin e sipërfaqes ndërtimore që kalon në favor të saj për nënshkrimin e akt - marrëveshjes përkatëse.

2. Kryetari i Bashkisë të ngrejë grupin e punës për marrjen në dorëzim dhe pasqyrimin në regjistrat e pasurive të paluajtshme dhe inventarin financiar të Bashkisë Elbasan sipërfaqet e përfituara sipas këtij vendimi. Apartamentet e përfituara regjistrohen si pronë e bashkisë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet edhe Agjencisë së Zhvillimit të Territorit.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës si dhe Drejtoria Juridike në Bashkinë Elbasan.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

640
25.05.2021
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKRETARIA

3 → ≠ 5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2283/1 **Prot.** **Elbasan, më** 25.05 **.2021**

VENDIM
Nr 60 **, datë** 24.05 **.2021**

"Mbi shtimin e numrit të punonjësve të Policisë Bashkiake"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të dates ____.____.2021, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria Administratës dhe Burimeve Njerëzore e Bashkisë mbi shtimin e numrit të punonjësve të Policisë Bashkiake; bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenet 8, 9, 54 të tij; ligjin 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore" neni 40; ligjin nr. 8224, datë 15.05.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe të Komunës", i ndryshuar; VKM nr.313, datë 01.07.2002 "Për caktimin e strukturës së numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të Policisë së Bashkisë dhe Komunës";

Vendosi:

1. Shtimin e numrit të punonjësve të Policisë Bashkiake, me 42 punonjës të rinj.
2. Fondi i pagave dhe sigurimeve do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë Elbasan.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI **KRYETAR**

Klajd GRIPSHI **Hektor Çiftja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Qemal Stafa", Tel. +355 54 400152, E-mail bashkia elbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al